



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:023448

Datë: 17.09.2024

Numri i dokumentit: 06171727

**Ac.nr.4094/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit C.M., nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.A.S., avokate në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M., zyrtar ligjor tek e paditura, me objekt të kontestit kompensim i pagës jubilarë dhe kompensim i ushqimit për ditën e pranisë në punë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe palës paditëse, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.243/2020, të datës 15.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 17.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, si dhe ankesa e paditësit C.M. nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.243/2020 i datës 15.11.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.243/2020 të datës 15.11.2021, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit C.M. nga Gjilani, dhe ka obliguar të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit t’ia paguaj në emër të emër të kompensimit për shpenzimet e ushqimit gjatë punës për periudhën kohore 18.04.2017 e deri me 17.04.2021, për 529 ditë punë të kaluara në punë tek e paditura nga 2.00 euro në ditë, në shumë prej 1,058.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, mbi atë shumë nga dita e ushtrimit të padisë me datë 14.02.2020, deri në pagesën përfundimtare, brenda 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe për një shumë më të lartë kërkuar se sa është dhënë për 421.50 euro, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite përvojë pune, me kamatë ligjore prej 8% mbi atë shumë nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, refuzohet si e papabuar kërkesëpadia e paditësit. Në

pikën II, ka obliguar të paditurën që në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit t'ia kompensoj paditësit shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, të prish aktgjykimin e atakuar C.nr.243/20 të datës 15.11.2021, dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje ose të refuzohet në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si e pabazuar në ligj.

Kundër këtij aktgjykimi përkatësisht pikës I të dispozitivit në pjesën ku është refuzuar kërkesëpadia e paditësit sa i përket shpërblimit jubilar, paditësi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditësit, të ndryshoj aktgjykimin e atakuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën prej 208 euro, në emër të përpilimit të ankesës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës dhe e paditësit janë të pathemelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarës së tij, me datë 14.02.2020, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës (shujtave), të precizuar në procesverbalin e datës 15.11.2021, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat e caktuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar si dhe shpenzimet e procedurës. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënës, dhe nuk kanë qenë kontestuese pothuajse të gjitha provat e prezantuara nga paditësi duke e bërë të besueshme dhe të themeltë kërkesëpadinë e tij. Tutje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se baza juridike e padisë ka rezultuar të jetë e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, me anë të së cilës në mes tjerash punëdhënësi, sipas

nenit 35 par. 7 të Kontratës, obligohet që punëmarrësve t'ia sigurojë shpenzimet e ushqimit, për këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësit t'i kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Ndërsa lidhur me pjesën refuzuese gjykata thekson se paditësi ka pasur jubileun e 30 me datën 23.03.2013, në kohën kur nuk ka qenë në fuqi asnjë Kontratë Kolektive apo akt tjetër nënligjor, i cili do të parashikonte të drejtën e paditësit në shpërblim jubilar. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 451 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk ishte kontestuese në mes palëve se paditësi është i punësuar në SHFMU "Musa Zajmi", në Gjilan, ku ende vazhdon të jetë në të njëjtën pozitë të punës tek e paditura dhe se kjo e fundit, në shkollën ku paditësi është e punësuar, nuk ka kushte të ofrimit të ushqimit në punë përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë formë tjetër, ndërsa nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se paditësi nga data 18.04.2017 deri me datën 17.04.2021, ka gjithsejtë 529 ditë të pranisë në punë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, përkatësisht me datën 18.04.2017, përcaktohet se: *"Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim"*. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017. Andaj, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar del se paditësi ka realizuar ditët e punës siç u theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga paditura ndërsa e paditura nuk ka mundësi të

ofrojë ushqimin përmes restorantit, kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër, atëherë mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit pjesërisht si të bazuar, duke ia njohur shumën përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë edhe sa i përket pjesës ku është vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar. Kjo pasi që me dispozitën e nenit 35, paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, shprehimisht parashihet se: *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i tyre i fundit, për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë, për 20 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë, për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë dhe për 40 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 150 % të një page bazë”*. Nga lista e pagave e Buxhetit të Republikës së Kosovës, për periudhën 01.11.2019 deri me 30.11.2019, dhe vërtetimi i datës nr.536/2019, i datës 17.12.2019, rezulton se paditësi ka përvojë pune prej 37 vite, ku referuar këtyre provave rezulton së i njëjti vitin jubilar prej 30 vite përvojë punë tek e paditura e ka arritur në vitin 2012, pra para hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, në të cilën paditësi e bazon kërkesën. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka konstatuar që kërkesëpadia e paditësit sa i përket shpërblimit jubilar është e pabazuar, pasi që paditësi nuk ka pasur vit jubilar 10, 20, 30, apo 40 vite, gjatë periudhës sa ka qenë në fuqi KKAK, duke qenë së i njëjti vitin jubilar prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2012, dhe me asnjë dispozitë të kësaj kontrate nuk është paraparë efekti prapaveprues, që do të thotë se e njëjta nuk gjen zbatim për rastet kur të punësuarit vitet jubilarë prej 10, 20, 30, apo 40 viteve i kanë plotësuar para hyrjes në fuqi të KKAK-së, siç është rasti i paditësit.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes”*. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënëse e paditësit, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t'ia bëjë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave, që

buron nga Kontrata Kolektive, është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afektojë në të drejtën e paditësit dhe detyrimin e të paditurës.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së, e po ashtu edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.4094/2022, datë 17.09.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci